Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

---

---

#### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- a) Kopje të vertetuara të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabel të licensuar, të konfirmuara me vule prane autoriteteve perkatese (Administrates Tatimore) të tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019).
- b) Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore, për vitet 2017, 2018, 2019, ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jete me vlerë më të ulët se 1,190,000 (Një milion e njeqind e nentendhjetë mijë) leke pa tvsh.
- c) Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes dëshmi për shërbimet e mëparshme, me natyrë të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 1,190,000 (Një milion e njeqind e nentendhjetë mijë) leke pa tvsh.

-si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO), për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe sigurinë mbi informacionin. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotëroj Çertifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit të perkthyer dhe të noterizuara:

- **ISO 9001** për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen
- OHSAS 18001 mbi “Standartet e sigurisë në punë” ose certifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.
- Certifikatën për menaxhimin e informacionit **ISO 27001** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.
- Certifikatën për menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen,

**Çertifikatat të jenë të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë autorizim prodhuesi (MAF) për të gjitha produktet dhe sistemet e ofertuara.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht për periudhën Nendor 2020 - Janar 2021 jo më pak se 6 punonjës, Kjo të vertetohet me dorëzimin :

- a) Listë pagesat e konfirmuara nga Organet Tatimore për periudhën Nendor 2020 - Janar 2021;

- b) Vertetim nga tatimet, qe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore per tre muajt e fundit, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku te pasqyrohet numri i punonjesve per cdo muaj.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te deshmoje qe ka stafin e nevojshem teknik te kualifikuar me kualifikimet e mëposhtëme:

- 2 (dy) Inxhinierë të diplomuar në një të një nga fushat: Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informacioni.
- 1 (nje) punonjes diplomuar në një të një nga fushat: teknik te sistemeve elektronike te automjeteve.
- Kandidati/Ofertuesi duhet te kete te pakten 1 punonjes te licensuar dhe te pajisur me certifikatat e trajnimeve perkatese te kryera nga kompania prodhuese e pasijeve te ofertuara.
- 1 ( nje ) punonjes te certifikuar ne graden EKSPERT ne databaza SQL
- 1 ( nje ) punonjes te certifikuar Project manager.
- 1 ( nje ) punonjes te certifikuar zhvillues aplikacioni.
- 1 ( nje ) punonjes te certifikuar Microsoft Profesional

Per sa mesiper, të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes se diplomave, CV, kontratave te punës dhe librezës së punës per cdo punonjes si dhe të paraqesë Vertetim nga tatimet, qe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore per tre muajt e fundit.

**SHENIM: Nje punonjes mund te kete 1 ose disa certifikime.**

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje projekt per menyren dhe grupet e punes qe do te realizojne instalimin e pajisjeve ne mjetet e AK, brenda afatit kohor te kerkuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: bashkelidhur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: **Sherbim GPS per mjetet**

**Afatet e ekzekutimit:**

Instalimi i pajisjeve GPS, duhet te kryhet brenda 3 diteve nga nenshkrimi i kontrates.  
Afati i ofrimit te sherbimit 12 muaj nga dita e perfundimit te instalimit te pajisjeve.



## Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCËS**

1. Përcaktimit të vendndodhjes së automjetit ne kohe reale me nje frekuence gjurmimi cdo 5 sec.
2. Informacion i detajuar për çdo makinë: Identifikimi i mjetit, shpejtësinë e lëvizjes, gjendja e motorrit ndezur ose fikur, adresën e vendndodhjes e sakte dhe e perditesuar, gjendja e baterise, gjenerimi i rrymes ne mjet, pershpejtimi I menjehershem, frenimi i menjehershem.
3. Raporte për kilometrat e përshkruara, orët e punës ndezur ne levizje dhe stacioner, shpejtësinë maksimale dhe shpejtësinë mesatare, km e pershkruara gjate orarit dhe diteve zyrtare te punes dhe gjate diteve te pushimit, raporte te qendrimin ne zonat e percaktuara dhe jashte tyre etj.
4. Raporte te karburantit të konsumuar gjate levizjes, furnizimi perkates sipas vendit, litrave.
5. Raporte ditore, javore, mujor mundësinë për tu exportuar dhe printuar në format pdf dhe exel.
6. Mundësinë e gjenerimit automatic të raporteve dhe dërgimi i tyre në adresa e-mail të parapërcaktuara.
7. Ruajtja e informacionit deri ne perfundim te kontrates dhe me tej duke i krijuar mundesine autoritetit kontraktor te mos humbase informacionin dhe pas perfundimit te kontrates.
8. **SISTEMI** : Aplikacioni software duhet te jete i perditesuar me modelin, hartat, raportet dhe sherbimet me te reja te publikuara nga prodhuesi. Operatori Ekonomik duhet te kete autorizim prodhuesi per kryerjen e ketij procesi per te gjithë kohen e mirmbajtjes 12 mujore te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.
9. **ASISTENCA (IT & Teknik)**: Operatori ekonomik duhet te ofroje asistencë sipas kerkeses ne IT dhe staf teknik me ekperience me kete sistem dhe paisje.
10. **ASISTENCA NE RAST DEFECTESH DHE MBAJTJE GARANCISE SHITESHE PER PAISJET + SENSORET**: operatori ekonomik duhet te garantoje asistencen Brenda 24 oreve per cdo defekt ose mosfunksionim te paisjes. Zevendesimin e paisjes pa kosto ekstra nese defekti eshte brenda garancise dhe jo i demtuar nga te trete.
11. Operatori ekonomik ka per detyre te beje trajnimin e stafit te Autoritetit Kontraktor perpara dorezimit te pajisjeve dhe te jete i gatshem qe per periudhen 1 (nje) vjecare nga lidhja e kontrates, ne baze te kerkese se Autoritetit Kontraktor, te organizoje me shpenzimet e tij, trajnimin e punonjesve te caktuar nga Autoriteti Kontraktor.
12. Hostimi ne server duhet te jete pa pagese shtese.
13. Suport te vazhdueshem per 24 ore ne dite.
14. Garancia e eficenses se pajisjeve te pakten 1 vite nga data e marrjes ne dorezim te pajisjeve apo instalimit te tyre.
15. Operatori telefonik duhet te sigurohet nga Operatori ekonomik fitues per 1 vjet nga data e marrjes ne dorezim te pajisjeve apo instalimit te tyre.
16. Hapesira ne server duhet te mbulohet nga Operatori ekonomik fitues per 1 vjet nga data e marrjes ne dorezim te pajisjeve apo instalimit te tyre.

17. Serveri duhet te kete lidhje te dedikuar me fiber optike 1 Gbit/s (Upload/Download).
18. HDD per ruajtjen e historikut dhe te te dhenave jo me te vogel se 3TB.
19. SSD per sistemin operativ.
20. Procesor server jo me te vogel se 2 x Intel Xeon E5, 2 x (10 x 2.20 GHz).
21. RAM jo me pak se 256 GB.
22. Sherbimi do te ofrohet per 12 muaj dhe do te faturohet muaj per muaj sipas nje procesverbali konfirmimi per marrjen e sherbimit

### **Specifikat e programit**

Ofertuesi duhet te ofroje nje sistem software per monitorim dhe raportim me keto parametra dhe vecori funksionale:

- Sistemi duhet te jete i aksesueshem nga kompjuteri dhe celulari (ne versionin mobile version), Mbulim te sakte te hartes se Shqiperise, Emertimi i sakte i rrugeve sipas emertimit te bashkise, Informacion mbi mjetet dhe kohen e tyre te gjurmimit, Informacion mbi historikun e levizjes se mjeteve, Mundesi printimi te hartese me historikun e mjetit, Informacion mbi gjendjen e mjetit, Harte GOOGLE satelitore, pamje reale dhe terren, Rifreskim I hartave dhe software jo me vone se 3 muaj, Raporte te detajuara mbi cdo aktivitet te mjetit, Njoftim me sms per alarme, Sistemi duhet të jetë plotesisht ne gjuhën shqipe.

- Sistemi duhet te kete te perditesuara te gjitha limitet e shpejtesise te aplikuara reale ne te gjitha rruget e Shqiperise. Ne baze te tabelave te kufuzimit te shpejtesise sistemi duhet te japi sinjalizimet perkatese ne sistem dhe ne mjet.

- Sistemi duhet te ofroje integrim me te gjitha sistemet ne pronesi te Autoritetit Kontraktor.

- Parametrat softwerike per integrimin me sistemet me siper, do ti vihen ne dispozicion ofertuesit pas nen-shkrimit te kontrates.

- Sistemi duhet te garantoje komunikim ne kohe reale me sistemet me siper dhe afishimin e informacioneve perkatese ne nderfaqen e perdoruesit.

- Sistemi duhet te mundesoje nje nderfaqe ku te shikohen ne menyre te permbledhur te gjitha detajet e levizjeve ne varesi te parametrave si: perdoruesi, distanca, zona gjeografike, data/ora.

- Sistemi duhet të ofrojë mundësi për të krijuar raporte përmbledhëse me informacion për të gjitha njësitet vartëse.

- Sistemi duhet te ofroje nje nderfaqe ku te menaxhohen lehtesisht i gjithe historiku i sherbimeve te mjetit.

- Njoftimet per historikun e mjetit duhet te vine ne forme raportesh, sms ne jo me pak se 20 numra te autorizuar.

- Duhet të ofrojë raporte “Business Intelligence” për drejtuesit dhe vendimmarrësit.

- Raportimi duhet të jetë i shumëllojshëm dhe të ofrohen informacione për çdo funksion apo për çdo njësi pune, në mënyrë të përmbledhur dhe analitike.

Ofertuesi duhet te ofroje nje sistem software per monitorim dhe raportim me keto parametra dhe vecori funksionale:

Sistemi duhet te jete i aksesueshem nga shfletuesit e ndryshem si Internet Explorer, Mozilla firefox, Google Chrome etj. Nje sistem i tille do te shkurtoje kohen qe i duhet stafit te departamentit te IT per te instaluar dhe konfiguruar nje aplikacion tradicional desktop.

Sistemi kërkohet të mbështetet në teknologjinë WEB dhe t'u mundësojë drejtuesve akses në çdo të dhënë për sistemin në çast, përmes një kompjuteri të lidhur në rrjetin e OSHEE SHA

Sistemi duhet të zhvillohet si pjesë e integruar e sistemit aktual duke u integruar plotësisht në nivelin e të dhënave (database), në nivelin logjik (server side), në nderfaqen e programit (client side).

Parametrat softwerike për integrimin me sistemet me sipër, do të vihen në dispozicion ofertuesit pas nën-shkrimit të kontratës.

Sistemi duhet të garantojë komunikim në kohë reale me sistemet me sipër dhe afishimin e informacioneve përkatëse në nderfaqen e përdoruesit.

Procedurat e Back Up:

Sistemi duhet të garantojë procedurë të qarta për Back Up periodik të dhënave. Të dhënat duhet të kopjohen në server të ndryshëm fizikisht nga server ku është instaluar sistemi.

Backup duhet të integrohet dhe unifikohet me procedurat aktuale të backup të sistemit aktual.

Ruajtja e historikut të ndryshimeve:

Sistemi duhet të ruajë historik të detajuar për ndryshimet që behen mbi entitetet. Në çdo moment administratorët e sistemit duhet të mund të shikojnë të dhëna mbi vlerën e vjetër, vlerën e re, përdoruesin dhe orën e saktë kur është kryer modifikimi.

Politika për shfrytëzimin e kodit burimor, arkitektura e sistemit:

Sistemi duhet të jetë me kod të hapur në mënyrë të tillë që stafi i departamentit IT të mund të zgjerojë apo modifikojë funksionalitetet e sistemit nëse do të jetë e nevojshme në të ardhmen. Arkitektura e sistemit duhet të jetë e shtresëzuar dhe kodi duhet të jetë i organizuar në klasa të ripërdorshme për të thjeshtuar zgjerimet/modifikimet e ardhshme. Sistemi duhet të jetë i gatshëm për integrim me sisteme të paleve të treta me anë të web shërbimeve. Web shërbimet duhet të garantojnë aksesimin e sigurtë duke përdorur kredenciale autentikimi dhe OTP (one-time password).

Sistemi duhet të jetë kompatibel për tu instaluar në server me sistem operimi Linux dhe Windows 2012.

Fleksibiliteti:

Sistemi duhet të jetë shumë fleksibel. Nëse kërkesat e ardhshme të OSHEE shpesh do të ndryshojnë sistemi duhet të akomodojë ndryshimet pa pasur efekte të rëndësishme të funksioneve ekzistuese. Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave:

OSHEE shpesh kërkon që kompania ofertuese të garantojë konfidencialitetin e të dhënave sensitive. Sistemi duhet të jetë i sigurt dhe të garantojë që informacioni në sistem, të jetë i vlefshëm sipas hierarkisë së përdoruesit. Për përdoruesit duhet të kenë akses vetëm në të dhënat që do të jepen të drejta, sipas përshkrimit të punës përkatëse dhe rolit që do të përcaktohet në sistem.

Sistemi kompjuterik i propozuar duhet të ruajë të gjitha veprimet e ruajtjes të bëra në të, me qëllim auditimin e sistemit.

- Për më tepër, me qëllim analizimin e ketyre të dhënave, sistemi duhet të jetë i pajisur me raporte përkatëse të organizuar për çdo përdorues, modul, etj

- Për çdo rast, të dhënat gjurmuese duhet të jenë të vlefshme për çdo veprim ruajtje që kryhet në sistem, për çdo user.

Vijimesia e biznesit (Business Continuity Center)

Kompania ofertuese të garantojë që sistemi përmban procedurë për funksionimin automatik në të dy datacenter të OSHEE-se (HeadQuarter dhe DisasterRecovery site). Në rast problemi në datacenter primare sistemi duhet të kalojë automatikisht në datacenter sekundare pa pasur nevojën e ndërhyrjes së personelit të OSHEE-se

Karakteristikat funksionale:

Ne nderfaqen sistemit, perdoruesit do te menaxhojne te gjitha te dhenat te cilat akumulohen nga levizjet ne terren, do te marrin raporte per konsumin e karburantit te nderlidhur me levizjet e mjetit, raporte per perdorimin e pajisjeve stacionare, raporte per mirembajtjen e tyre te nderlidhur me servisimin e mjeteve, raporte operacionale, dhe gjithashtu do te marrin raporte te ndryshme per performancen e personelit dhe raporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes. Nderfaqja e administrimit duhet te jete e thjeshte dhe intuitive per te perdorur ne menyre te tille qe te minimizojte kohen e nevojshme per ambjentimin e perdoruesve me te. Sistemi duhet te mundesoje nje nderfaqe ku te shikohen te gjitha konsumet/detajet e levizjeve si dhe perdoruesin (personeli i OSHEE-se).

Sistemi duhet te mundesoje nje nderfaqe ku te shikohen ne menyre te permbledhur te gjitha detajet e levizjeve ne varesi te parametrave si: perdoruesi, distanca, zona gjeografike, data/ora.

Sistemi duhet të ofrojë mundësi për të krijuar raporte përmbledhëse me informacion për te gjitha njësite vartëse.

Raportimi duhet të jetë i shumëllojshëm dhe të ofrohen informacione për çdo funksion apo për çdo njësi pune, në mënyrë te përmbledhur dhe analitike.

Për çdo kategori raportesh programi duhet të mundësojë filtra nëpërmjet të cilave përdoruesi përzgjedh sasinë dhe llojin e informacionit që kërkon të shohë.

Sistemi duhet te ofroje mundesine e printimit te raporteve me siper (te detajuara ose te permbledhura) ne format PDF ose ne printerat e shoqerise.

Sistemi duhet te ofroje mundesine e upload te dokumenteve te ndryshme, si liste pjesesh kembimi, liste mjetesh, foto etj

Ofertuesi duhet te ofroje trainim per perdorimin e sistemit software per personelin e OSHEE-se.

Ofertuesi duhet te ofroje trainim per perdorimin e sistemit software per personelin e Autoritetit Kontraktor

## **SPECIFIKIMET E PAISJES GPS**

### **MARRESI GSM**

- Paisja duhet te ofroje GSM QUAD BAND 698-960/1700-2700 MHz
- GSM duhet te jete jo me pak se class 12
- Te suportojte dhe komunikimin SMS

### **MARRESI GPS**

- Paisja duhet te ofroje te gjitha keto satelite te gjurmimit GPS, GLONASS, GALILEO, BEIDOU, SBAS, QZSS, DGPS, AGPS
- Saktesia e gjurmimit duhet te jete < 3m
- Sensitivitet gjurmimi jo me te vogel se 165 dbm
- Protokoll jo me pak se NMEA -183

Lidhjet

- Paisja duhet te kete jo me pak se nje hyrje dixhitale per dedektimin ne kohe reale te gjendjes se motorit.
- Paisja duhet te kete jo me pak se dy hyrje dixhitale per lidhjen me sensore te tjere.
- Paisja duhet te kete jo me pak se nje hyrje analoge monitoruese (10V/30V)

- Paisja duhet te jete e paisur me sensor levizje
- Paisja duhet te superoje rryme hyrese jo me pak se +10 deri +30 V DC
- Paisja duhet te kete mbrojtese nga mbirryma
- Paisja duhet te kete memorie te integruar jo me pak se 1MB
- Paisja duhet te kete antene shume te fuqishme GSM te integruar
- Paisja duhet te kete antene GPS te integruar
- Paisja duhet te kete bateri LiPo te integruar jo me pak se 160 mAh
- Paisja duhet te kete porte USB

Gjate periudhes se kohezgjatjes se kontrates kontraktuesi **detyrohet te beje** me shpenzimet e veta instalimin e pajisjeve GPS ne mjetet e OSHEE Group sh.a. si edhe zevendesimin e pajisjeve qe rezultojne me difekte.

E gjithë sasia e pajisjeve te nevojitura do te ofrohet nga Operatori Ekonomik, te cilit i lind e drejta e terheqjes se tyre pas perfundimit te afatit te kontrates. Ne perfundim te afatit te instalimit do te hartohet nje liste e sakte me pajisjet e OSHEE sh.a dhe pajisjet e Operatorit Ekonomik te instaluar ne mjetet e OSHEE sh.a , kjo liste do te jete pjese e pandare e kontrates se lidhur mes paleve.

Lista e Drejtorive Rajonale me numrin perkates te mjeteve.

<i>Nr</i>	<i>Drejtoria Rajonale</i>	<i>Nr mjeteve</i>
1	DR Tirane	54
2	DR Berat	26
3	DR Durres	26
4	DR Elbasan	27
5	DR Fier	23
6	DR Vlore	10
7	DR Gjirokaster	18
8	DR Korce	19
9	DR Burrel	19
10	DR Shkoder	28
11	DR Kukes	8
12	DTL Fier	11
13	DTL Veri	11
14	DTL Tirane	6
15	DTL Elbasan	8
16	DTL Qender	7
17	DSHM	25
18	DKRH	12
	<b>Total</b>	<b>338</b>

(lista me targat per cdo mjet i vihet ne dispozicion operatorit fitues).

Instalimi i pajisjeve GPS, afishimi i mjeteve ne aplikacion duhet te kryhet brenda 3 diteve kalendarike.

Afati i ofrimit te sherbimit 12 muaj nga dita e perfundimit te instalimit te pajisjeve dhe hartimit te procesverbalit perkates.

## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---



\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsytet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 15.

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbale të lidhjeve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nenkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nenkontraktuesin një dispozitë që premtë ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
